



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:022735

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05817066

**P.nr.30/21**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.19/24 të datës 10.06.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit I.V nga fsh....-Kaçanik, dhe të dëmtuarit B.S nga Ferizaj, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.128/21 të datës 05.02.2021, për shkak të veprës penale, Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 13.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.19/24 të datës 10.06.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit I.V nga fsh...-Kaçaniku, dhe të dëmtuarit B.S nga Ferizaj.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.128/21 e datës 05.02.2021 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit I.V nga fsh....-Kaçanik, i lindur me datë ..., me nr. personal: ..., për shkak të veprës penale, Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.128/21 e datës 05.02.2021, e ka akuzuar të pandehurin I.V nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.06.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si P.nr.30/21, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 10.06.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.07/24, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit I.V dhe të dëmtuarit B.S.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**P.nr.30/21 datë, 13.06.2024**

Sekretarja Juridike  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.